

VENDIM
Nr. 672, datë 30.10.2024

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM LETRASH, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE CASSA DEPOSITI E PRESTITI S.P.A., PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE S.P.A. ITALI, PËR PROGRAMIN E RISTRUKTURIMIT TEKNIK DHE MENAXHUES TË KESH SHA, DHE FUQIZIMIN E SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9134, DATË 11.9.2003

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes me shkëmbim letrash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për ndryshimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale S.p.A. Itali, për programin e rristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH sh.a., dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar, ratifikuar me ligjin nr. 9134, datë 11.9.2003, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Cdp

Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Zhvillimi Financiar
bu_frc@cdp.it

Sh. Saj., znj. Delina Ibrahimaj

Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Qeveria e Republikës së Shqipërisë

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj

Drejtoria e Koordinimit dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj

Sektori i Sigurimit të Ndihmës së Huaj dhe Marrëveshjeve

“Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Romë, 18.8.2023

Lënda: Marrëveshje Financiare me vlerën 41.528.041,03 EURO, F.Rot/Aid 03/006/00, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financës dhe M.C.C.S.p.A (sot Mediocredito Centrale S.P.A), për Programin e Ristrukturimit Teknik dhe Menaxhues të KESH sh.a. dhe fuqizimin e Sistemit Elektrik Shqiptar

E nderuar Zonjë,

Referuar lëndës dhe në vijim të shkresës bashkëlidhur, datë 23.2.2022, dhe përgjigjes suaj, bashkëlidhur, datë 7.3.2022, kemi kënaqësinë t'iu informojmë se periudha e disbursimit për kredinë e butë të lartpërmendur është shtyrë deri më datë 30.4.2026.

Me respekt,

Mediocredito Centrale S.P.A
Fondet Qarkulluese për Zhvillim
Nënshkrimi Vula


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT
TË NDHIMËS SË HUAJ
DREJTORIA E BASHKËRENDIMIT DHE SIGURIMIT TË NDHIMËS SË HUAJ
SEKTORI I SIGURIMIT TË NDHIMËS SË HUAJ DHE MARRËVESHJEVE

Nr. 26301 Prot. Tiranë, më 17.2.2022

Lënda: Mbi Programin e ristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH, sh.a., dhe fuqizimin e sistemit elektrik Shqiptar

CASSA DEPOSITI E PRESTITI
Adresa: Rruga Goito, 4 - 00185 Romë, Itali

I referohem Konventës Financiare të datës 16 korrik 2003, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe MCC S.P.A, për Programin e ristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH, sh.a., dhe fuqizimin e sistemit elektrik Shqiptar, si dhe shkresës suaj të datës 28.9.2021, me anë të së cilës jemi informuar mbi shtyrjen deri më 30.4.2022 të afatit të disbursimit.

Megjithatë, konsideruar që me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve që do të financohen nga kjo Konventë Financiare nevojitet një afat më i gjatë, nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

- shtyrjen me 4 vjet të periudhës së disbursimit, përkatësisht deri më 30 Prill 2026, të përcaktuar sipas nenit 4.1, të kësaj Konvente Financiare.

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbejnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të Konventës Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe MCC S.P.A, për programin e ristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH, sh.a., dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar.

Ky Marrëveshje Ndryshuese hyn në fuqi, pasi pala shqiptare do të njoftojë Cassa Depositi e Prestiti për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.

MINISTËR

Delina Ibrahimaj